



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenin 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2009 për dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 84/18, dt. 29.03.2018, si dhe me propozimin dt. 03.09.2019 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural për fillim të procedurave për dhënie në shfrytëzim të vendgjuetive të përbashkëta në territorin e Komunës së Vushtrrisë përmes shpalljes së ofertës publike në mjetet e informimit publik.
2. Obligohet e Drejtoria për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të vendgjuetive ta bëjë në pajtim me Ligjin në fuqi për Gjyëtinë në Kosovë, Udhëzimin Administrativ nr. 06/2009 për dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta dhe akteve tjera me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN

UZ Nr. / Br. 1101 / 19

Nr. i fq. / Nr. sht.

Data: / Datum. 18.09.2019

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesën e datës 02.09,2019 të Organizatës “DOWN SYNDROME KOSOVA” Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohen mjete financiare në shumë prej 990.00 € (nëntëqindnëntëdhjetë euro) për pagesë të shpenzimeve për realizim të vizitës së 9 personave, gjegjësisht, 5 fëmijëve me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë dhe 4 prindërve të tyre, për realizim të vizitës 5 ditore në bregdetin e Shqipërisë.
2. Mjetet financiare në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Vushtri.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafër Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit të Sekretarisë.